

BIBLIOTEKA

85H-1
B21.

SHTETI

GJIROKASTER

Adelina Balashi

Peregrinje

poezi

814-1
—
1321.

Republike
AMONIT ARIKAA

*Adelina
Balashi*

655 //

24494

PËRGJIGJE
poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËR»

KONGERI

KJO DITE

Nuk e di ç'kish më të bukur kjo ditë,
a thua më e qeshur pranvera zbriste?
— I mblodhëm për ty, mësuese, — më flisnin
më të bukurit në botë, sytë e fëmijëve.

— Pa ejani këtu, ja, këtu, pranë meje,
kaçurrelat e bukur e të butë t'ju puth,
t'ju numëroj gishtat në mbledhje e zbritje,
bashkë me pranverën në jetë t'ju fut.

Dhe një nga një të shkelni
me këmbëzat e vogla,
hapnxitimthi të hyni në zemrën time
e unë krahët pash më pash t'i hap, sa dielli,
të brishtat ëndrra t'jua nis në fluturime.

KONCERTI I FËMIJËVE

Hapini dritaret, dyert,
sallat, sheshet,
le, të dëgjojnë të gjithë koncertin e fëmijëve!
Në sytë e tyre pranvera
i shkundi të gjitha:
lulet, fillatin, diellin, agimet,
mëngjesin e nesërm të të gjitha stinëve!
O duar të vogla, të buta,
që zemrat tuaja në tinguj vini,
ç'udhë të reja do të çelni nesër?
C'pallate do të ngrini?

Unë e di, në këngën tuaj, të bukur
jetë merr socializmi.

SHËSHI 31. VITI DITËVITORE

**baballarët fidanë rritin me duart e dashura,
vetveten ripërtërin njerezimi.**
dëgjoni vittur i vik e jeta i lindurit së puto
Hapini dritatët, dyert,
sallat, sheshet

dhe dëgjoni të gjithë koncertin e fëmijëve...
Gjithçka që është e vlefshme, e rënës
e lindurit, që është e rënës bërtor tashmë që
në këtë ditë, që nuk nuk ka më çuditë
lindurit, që është vërtet.

Ditë e vërtet
në qytetin e vërtet, që është vërtet
lindurit

që është vërtet, që është vërtet
lindurit

DUKE PRITUR NJË LETËR

Gjethet e vjeshtës që fëshférinin, që shkisnin dritares e bini i ngadalë nga padurimi i pritjes dhe i pritjes prapë me letrën tënde të padërguar më ngjanë.

Tani shirat-litarë lagin udhë e brigje, drurët e zhveshur nga erërat mërdhijnë po njerëzit prapë merren vesh me njëri-tjetrin, dërgojnë letra dhe përgjigjet vijnë.

Megjithatë letra jote s'erdhi!

Pati frikë të vijë,
pati frikë të ngjitet në fshatin tim
të lartë
tani që vjeshta shkund gjethet
e copëra vetëtimash skuqin në qafë.

II. LITERATURË

Dhe unë duke harruar letrën tënde
pranë dritares ulem, pranë dritares rri,
dhe i shoh gjethet që bien
dhe e lë pritjen të laget në shi.

Se marr qindra përgjigje nga zarfi i jetës
ku janë mbledhur të gjitha fjalët,
të gjitha dashuritë,
më mbush me jetë përshtendetja, e nxënësve
që më urojnë mëngjesin e mirë çdo ditë.

Qëndrësoj se më iku që i kishte vlerë më shumë
gjithashtu që i kishte vlerë më shumë
se i kishte vlerë më shumë
e që i kishte vlerë më shumë.

P E I Z A Z H

Fëmijët në anë si zogjtë
prapë ugarit rendin me gaz,
fillad' i pranverës u lot nëpër fage
shami e lidhur u rri në qafë.

Estoj i lloxx sëga oigjigjet tiflos.
Ja, qetë ndaluan te mesi i arës
dielli shtrirë u rri në kurri,
djersa nën shpatull u bie ngadalë
pikëz e artë derdhet mbi plis.

Ndalon edhe bujku, shkon dorën në qafë
ulet një sy gazetës t'i hedhë,
toka si nusezë e begatë
mbarsjen nga dor' e tij pret.

LAWA TAKHMA QUM

Redin vajzat aty këtu krahëflutra,
pikë djerse pëllëmbë për pëllëmbë^o njerëzini
ç'mbolli dorë e tyre^{ja} fusha^{ja} tjetër bëm
një gëzim sa deti, një pranverë të tërë;

shqiptar

Grusht i t'i që^{ja} shpëtë^{ja} është më i rëndë^{ja} që

shqiptar^{ja} shpëtë^{ja} është më i rëndë^{ja} që
shqiptar^{ja} shpëtë^{ja} është më i rëndë^{ja} që
shqiptar^{ja} shpëtë^{ja} është më i rëndë^{ja} që
shqiptar^{ja} shpëtë^{ja} është më i rëndë^{ja} që

NJË GRUSHT ARRA

Nxënësit e mifit që dëgjat që t'ju dhuroj,
më sollën arra një dite.

dhe mbi tryezë m'vleshuan ngadalë; marrë, që
pastaj ulën kokat sikur s'e kishin

mendjen,
që mua zor mos më vinte për t'i marrë.

Me siguri, mendova,

ua kanë dhënë nënët e mira
që t'i hanë kur të bjerë zilja për pushim
e ata prej racioneve të tyre
kishin hequr nga një kokërr
që të nxirrnin dhe racionin tim.

ALBANI ET TIRANA TË TANQELIM

qind e qe zot i dashur me gjithë shtë
Dhe zor më erdhj, vërtet, për t'i marrë
e supet m'u drodhën nga kujdesi i tyre
nga kjo dashuri e brishtë, fëmijësh që i kalojnë
që fshehtas më ndiqte me çipat e syve.

Me qëndrimos filloi një dëgjimi
të përgjithshëm të fëmijëve që
po i kalojnë dashurinë e vjetër
me këtë qëndrim.

MINATORET E TURNIT TE TRETE

Ata ecin pa zhurmë, ata ecin pa bujë
në rrugën¹ku hënë faqet²imbështet,
mes rrudhave dikujt galéri³i zgjohet⁴ ne
stacioni i parë i lidhës që vjen.
Dhe atje thellë zemra e malit
e ndien si zbutet nga djersa e tyre,
mes llambave rend elektrovozi
si mes yjeve...

NETËVE TË VERËS

Ku e gjetët këtë hënë të bukur
që hapësirës pash më pash i bie?
Këtë fërgëllim të émbel të fushave
me kallëza gruri si epilog dashurie?

Të rend dua e këngës t'ia them
me simfoninë e zhurmshme të kombajnave,
të pres vesën e mëngjezit sic pret fusha
shamitë e rëzuara të vajzave,

epilog i tij është shumë i saktë
dilekti që t'i luftohet nuk është
një dëgjimi i pëllumbave, i saktë
një dëgjimi i pëllumbave.

ÇARTA SË ANVARIT ÇAPI YNE

Nga etërit s'trashëguam
thjesht grupin e gjakut,
daljen e mollëzave,
kaltërsinë e syve.

Vëre dorën tek zemra
dhe ke pér të ndier
rrahjen e pulsit të tyre.
Hidhi sytë së nesërmes:

Të njëjtat gjurmë, të njëjtat goditje,
të njëjtin ritëm, të njëjtën dashuri,
të njëjtat lule, male, stinë, këngë,
të njëjtin puls:

jemi zemra jote, Shqipëri!

LIRI GEROS...

Unë sytë e bukur si dëti
s't'i kam parë,
as gërshtetin e shpleksur,
as ballin e ndritur si hëna.

Vec
i besoj zemrës së nënës që të lindi,
i besoj isos së popullit te kënga.

Shikojqë qëqëri njerëzit nuk kam
i këndoj mundur këngën. Dhe jo
pofta(0) angjelit o
pofta(0) vallorësimos

pofta(0) vallorësimos

PARA BUSTIT TË SHOTE GALICËS

Mbi supet e tua të ngritura

vjen të ulet e sec të thotë ca fjalë,
por ti, moj Shote, rri aty e bronztë
me një shqetësim të patretur në ballë...

Dhe sytë tutje-tëhu venë e vijnë,
dhe sytë

mallin nderin nëpër bjeshkë
— O ti, Gjalicë! E bucura Gjalicë,
e thinjura Gjalicë,
zemërmadhja Gjalicë!

Mos ma harro këngän.
në t'u dashtë krîsma ndonjëherë,

mos ma harro pushkën
në t'u dashtë krisma ndonjëherë,
mos ma harro zemrën
në t'u dashtë gjaku ndonjëherë,
mos ma harro èndrrën
në m'u mbyllshin sytë ndonjëherë!

Dhe sytë tutje-tëhu venë e vijnë...
Mbi supet e saj të ngritura

shqiponja
vjen i ulet e seç i thotë ca fjalë,
ca fjalë klithma, të ashpra, të çuditshme,
ca fjalë në gjuhën e shqipeve...

Kukës, 1979

82464.

17

NJE MËNGJES TEK MIGJENI

Zgjohu, poet!

Të paktën këtë mëngjes të bukur

dhë vogëlushëvë të mi^b mos ua prish! zgjohu

Merr pakëz nga gëzimiⁱ i tyre

vëre në buzë
dhe çelu,

merr pakëz nga dashuria e tyre

vëre tek sytë
dhe qeshu,

mërr pakëz nga shëndeti i tyre

vëre në zemër
dhe ngrehu...

Ngrehu, poet!

Nxënësit e mi kanë sjellë

lule kaq të bukura

dhe lehtas të fshijnë supet
e lagura me vesë prilli,
sytë e tyre seriozë bëhen çuditërisht:
«Kafshatë që s'kapërdihet
asht' or vlla mjerimi!»

Oh, po ata s'arrijnë ta kuptojnë
tragjedinë e vërtetë të mjerimit të madh,
për shkak të tij po vdiste vetë poeti
me zemrën shqyer nga vargu në varg.

Për shkak të tij
anemike ishin ditët,
anemikë njerëzit, mëngjeset shterpë,
mbështillejjeta në një kokërr misri,
çmbështillej vdekja, jetë legjendë!

Oh, po ata prapë
s'arrijnë ta kuptojnë
dhe dëri në fund s'mund t'ia ndiejnë
kafshimin e vërtetë.
Zgjohu, poet, të lutem,
çaje zemrën dhe folu vetë!

Zgjohu, poet,
merr pakëz nga gëzimi i tyre
vëre në buzë
dhe çelu,
merr pakëz nga dashuria e tyre
vëre tek sytë
dhe qeshu,
merr pakëz nga rinia e tyre
vëre në žemër
dhe ngrehu...

BLIRËT NË MBRËMJE

Ndanë bulevardeve blirët rrinë
me kurora të bukura si flokë vajze,
era e mbrëmjes si dialog i çuditshëm
u shkund luleverdhat, trotuareve.

Asgjë më shumë s'do të kërkonin prej tyre
ata që sonte bëjnë dashuri të ndershme
veç puhizës erëmirë nën fletë
dhe zgjatjes indiferente të degëve.

Ndanë bulevardeve blirët rrinë
mbështetur pas ëndrrave
dhe dashurive të nesërme...

NA ISHTE NJË DHE...

Do ndalojë treni në stacionin e fundit
dhe ti do më presësh i lagur në shi,
çadra rënduar nga uji do shfryjë:
— Na ishte një dhe u bënë dy!

Dhe supët s'do na i mbrojë nga inati,
le të lágën, do thotë, — kështu e kanë kokën!
Sa mirë që s'ia marrim vesh gjuhën,
që s'ndiejmë shiun, të ftohtët.

TË KISHA THËNË...

Të kisha thënë se do të të marr në telefon
kur ora të bjerë dymbëdhjetë,
të të uroj për të dashurit, njerëzit,
e ne të dyve bashkim të shpejtë.

Të kisha thënë se do të ngre një dolli për ty
(jo me zë të lartë, natyrisht),
të kisha thënë eja këtu lart, të presim,
me borë dhe cicërima fëmijësh.

Të kisha thënë... dhe ti erdhe,
si urimi më i bukur këtë mbrëmje,
jashtë dëbora mbi majë pishash
me suferinë ngrinte dollinë tënde.

MALL...

Autobusi, duke lënë prapa
vrapin e erës
ecte me dyzet kilometra në orë
ndërsa në fytyrat tona reflektoheshin pemët,
na i bënin me dorë.

Dhe pa e marrë vesh as vetë se si
vjeshta me fytyrën e nënës
m'u ngatërrua
dhe më ngjanë gjethet e zverdhura tek binin
me lotët e herës së shkuar.

Atëherë malet m'u bënë shkallë
dhe krahët e zogjve parmakë m'u bënë
dhe ashtu duke rendur si në
një ëndërr të bukur
trokita në shqetësimin tënd, moj nënë.

U GENJEKERKE LEHTE

Për të të thënë: «Të dua!»
s'mjaftojnë veç sytë e bukur, moj vajzë.

Për të të thënë: «Të dua!»
duhet ndier thellë
dhe çiltërsisht duhet ndier,
siç ndiejmë rrahjen e gjakut në damarë
dhe zgjerimin e frysma marrjes në pranverë.

Duhet një botë e tërë e ngrohtë,

e mirë

që tek tjetra të hyjë lirshëm
dhe lirshëm të ndihet
njëzimi i të dyjave,
pa lustrimin e vetes,

pa sforcimin e tjetrit,
pa ndotjen e llogarive.

Ndaj ti, që e pret dashurinë
nga sytë blu nënvizuar me bojë
ja ku të them: u gënje kërke lehtë.
Për hir tënd, dashuria
veten s'mund ta ndryshojë!

KUR VJEN PRANVERA

Dhe në i nibyllsh ti
dyer e dritare
pranvera rrugën e gjen përsëri
dhe bëhet erë, dhe bëhet ajër
dhe pa të pyetur vjen tek tili
— Ngrehu, të thotë, eja,
eja të dalim në fushat e lara nga vesa,
të dëgjojmë zhurmë traktorësh e përshëndetje
njerëzish,
të ndiesh vlagën e tokës që kthëhet përbys
dhe thith farë në gjoksin e gjerë
si më e mira nënë,
të ndiesh dridhjen e zogut që puth filladin
me krahë
e bashkë me të të ngrihesh në fluturimin e parë.

Eja! Eja dhe shih shpërthimin e sythit
të gjelbër
që sjell frytin në jetë si dashuria njerëzit,
dëgjo buçimën e ujërave në lumë
dhe këngën e re të zogut në brigje,
shushurimën e pyllit të sapozgjuar
që bren erërat me dhëmbë
e shkund krahët në ahishte.
Eja dhe ndalu diku,
pusho e prapë ecë, vrapo pa u ndalur një herë,
dy herë, një mijë herë,
ulu e qeshu mes gëzimit të njerëzve,
hyr në zemrat e tyre
dhe bëhu vetë pranverë!

Dhe në harrofsh ti mbyllur dyer e dritare
pranvera rrugën e gjen përsëri,
dhe bëhet gaz, dhe bëhet jetë,
dhe vjen të ulet ty në sy.

KA CA FJALE TË TILLA

Ka ca fjalë të rënda,
ca fjalë gjemba,
që mbiijnë rrugës pa nja pyetur
ty dhe mua,
që vërtiten si gjethë të zverdhura
nga era e mendimeve të liga,
ca fjalë shtriga,
që zënë e sillen si hije
në mendimet e dashura të prindërve,
ka ca fjalë të tilla...

Po ti mos u dridh prej tyre,
i dashur,
mos rri prej tyre netëve pa gjumë!
Ja, merr buzëqeshjet e qindra njerëzve të mirë
dhe hidhi drejt meje si urë!

VAJZË E FUSHËS, LULE E FUSHËS

(Motiv populor)

Pikoi vesa e mëngjesit
zgjati dielli syn' e zjarrtë,
nëpër fushë q'ta ndjeva hapin,
vashëzo, sheqer e mjaltë.

Bëj të them një fjalë te veshi
po ti ikën, bëkesh erë,
rend e qesh si lule fushe,
thuamë ç'dorë, të kë mbjellë?

Do të vij si fillad i majit
do të gjej, moj lule fushe,
në më iksh do të të vij prapa,
në qëndrofsh do të të marr nuse.

MËSHTEKNA E BARDHË

Ç'e mirë të solli këtej, moj e bukur,
e vetme në pyll, pranë lisit të lartë,
mështekñez e brishtë me gjethet që dridhen,
nusezë moj, me rrobe të bardhë!

Pa vjen rojtari i pyllit me natë
dhe trastën me bukë e var në një degë,
dhe bën çudi me 'ca' gjurmë të freskëta
dhe të shikon me dyshim, moj mështekñë.

Po ti krahët shkund e gjëhet përplas
dhe kokën mbështet pas lisit të lartë...
Ç'i kujtove rojtarit vajzën e vetme,
nusezë moj, me rrobe të bardhë.

PEIZAZHE SHTATORI

Një ditë shi,
dy ditë shi...
Shiu tri ditë me radhë
nuk pushoi
dhe diku në qytet
lagte patjetër bulevardet,
trotuaret,
flokët e bukur të vajzave
që qeshnin
e përplasnin sandalet...

Një ditë shi,
dy ditë shi...
Shiu tri ditë rrođhi
me shtëmba...

Unë nëpër baltë nxitoja drejt shkollës
për të futur kalamajtë brenda.

Një ditë shi...
dy ditë shi...
Mbi tryezë se nga u gjendër.
ca mollë të embla:

KOSOVE...

Male të ngritura
si koka njerëzish
që shtyjnë mjegullat me supe,
koka njerëzish
të ngritura si male
në shtegtime refrenesh epike!
Kosovë,
vend malesh dhe njerëzish
me dashuri të pafundme...

TE SHTËPIA E VJETER

Shtëpi e vjetër me dyer të rëna,
ç'më shikon e trembur, moj e shkretë,
unë s'jam as shi, as erë e tramundanë
që ngre çatinë përpjetë.

Erdha të rri pak këtu tek pragu
që fëmijinë lehtas mia përçollë,
të çmallem me qershinë krahërrëzuar
të rend e të loz zbatur tek oborri

Të shoh të kthehen dallëndyshet varg
tëk çerdh' e vogël mbi dritaren time,
të pres të qeshë pas avllisë hëna
dhe xixëllonja të kap në fluturime.

Të ndiej hapin e gjyshes nëpër shkallë
dhe zën' e ëmbël lehtë si gurgullimë;
— Më paske ardhur, bijo, të më shohësh?
— Pa shih, pa shih! Ma mbushe gjithë shtëpinë!

Po tra i kalbur që rrëshqet e bie
i ashpër më troket, më zgjon.
Qershi e plakur krahët shkund me dhimbje
e trembur dallëndyshja fluturon.

Shtëpi e vjetër, mos u mërzit me mua;
me deformimin e dyerve, penxherëvê,
kjo s'është veçse dëshmi e rrojtjes
dhe e shërbimit deri në fund
ndaj njerëzve.

J E T È

Në zemrat tuaja të buta
rrugët lanë gërvishtjen e potkonjve
dhe erën dehëse të temjanit...

Në zemrat tuaja trokitjet
copa-copa jù thyenin
shikimin e parë të djalit.

Në zemrat tuaja
pak vend kish për zemrat,
pak për sytë, për buzët,
pak për ëndrrat dhe asgjë për të dielat.
Dhe një mëngjes pagdhirë
ju nisin në udhën e ndarjes...
(Një rrugë dhe një heshtje
ju bënte nëna aq papritur).

Ja, rruga e gjyshes hipur mbi një kalë,
mbi një kalë të bardhë,
rrug' e nënës shkelte mes orizit
dy gisht mjaltë në ballë...
«... Dy gisht mjaltë në ballë,
dy gisht mjaltë në buzë,
na bëfsh një djalë me emër,
të mos i shuhet nami kurrë...»

Por ja!
Erdha unë me zërin e dridhur
me sytë e qeshur, me belbëzimet e para,
fëmijnia ime te fustani me pika,
duart e gjyshes te faqet e mardhura.

Dhe ëndrrat tuaja i ngrita në këmbë,
e lartësive ngjitem e lehtë,
dasma ime me një tufë mimozash
më e thjeshta, më e bukura jetë!

VINTE NJË MANDATE

«Kthehu, kurbetçi i nënës, kthehu,
se kam mall e s'më tret dheu»,
»

Koha rrhidhte e merrte me vete
dhimbjen e nënave,
motrat shpejt i thinjte,
eshtrat tuaja s'di se ku
nëpër botë i shpërndante
me kujë...
Dhe zëri i të dashurve ju vinte
i largët,
i shurdhët, i mekët,
me një belbëzim fëmije në mes:
«U bëra me vajzë, u bëra me djalë
Oi... oi i...»

Ngriheshin ato

me shpirtin ndër dhëmbë
bijve vinin t'u jepnin uratë...
Pas dritareve buzët mbeteshin të ftohta,
pas mëngjesit vinte një mandatë.

Dhe ngjethej toka nga malli e loti,
në gji të vajzës vyshkej borziloku...
Por prapë nënrat

mbi dhembjet u ngriten
dhe lotët i mbyllën thellë në zemër,
se të vegjlit luanin me gëzhoja fishekësh,
se u duhej t'i rritnin

për një kohë tjetër

NE QERREN E MADHE SA BOTA

Qerrja jote e madhe sa bota,
 xha Shaqo,
 hipin e zbresin fëmijët me fytyra
 të çelura
 dhe ti buzëqeshjen u vë përpara
 si një lodër të madhe
 në këtë mëngjes gazmor me cicërima.

Dhe, padashur, dora të shkon tek plaga e vjetër
dhe të thellohen rrudhat e dhimbjes në ballë,
ndërsa fëmijët me doçkat si bisqe
drejtimin e qerres kanë marrë

Dhe kështu si ata, me dëshirën e bardhë,
pate hipur dikur në qerren e agait

dhe «hyaaa...» pate rënduar me duart e vogla
në kurrizin e dirsur të Murrashit.

Por papritur, si një haraç i pafalshëm,
në sup të qe ngulur kafshimi i meshintë
dhe përdridhej kamxhiku-gjarpër në diell
i dehur me gjakun tënd prej fëmije...

Dhe mirë s'të vjen t'ua prishësh gëzimin
kur e di se qerret rrugë s'do të ndërrojnë...
Ata «hyaa!...» bëjnë me doçkat si bisqe,
me sytë diell që çdo lodhje largojnë.

DUKE SHPJEGUAR NAIMIN

Do ta besoje vallë se një ditë
një vogëlushe me kaçurrela të verdhë
do recitonte kaq bukur «Pranverën» tënde,
më faqekuqe se vetë pranvera?

Në sytë e tyre ti hyre i téri
siç hyn prilli me lulë e vesë,
kështu veç ti mund t'u trokisje në zemra
me dashurinë e madhe, me fjalën e thjeshtë.

Dhe ata flasin e shkruajnë aq bukur
gjuhën e ëmbël: gjuhën e vlerë...
Ti nga dritaret vjen e zgjat kokën
sikur një këngë të re na ke sjellë...

NË QYTETIN TËND UNË ERDHA RASTËSISHT

Në qytetin tënd
unë erdha rastësish,
fare rastësish,
si çdo udhëtar që për çlodhje
i pashë dhe selvitë e vjetra,
për të cilat më flisje aq shumë.
ndalet diku,
dhe portokallet

Dhe më ngjanë profilet e tyre
me ecejakun tënd të heshtur,
me ecejakun tënd të menduar.
buzë rrugëve

Dhe s'u çudita aspak
 kur mes tyre
m'u shfaqe ti, pa ftohjen e vjetër,
më zgjate dorën e madhe, të ngrohtë
dhe në shtëpi më ftove me gjithë zemër.

DËBORA ZBARDHI MALET

Gjyshi im bari ka qenë tërë jetën
dhe njoju fusha e pyje me pëllëmbë
dhe dimrit huqet ia dinte aq mirë
se flinte netëve në stane me dhëntë.
Tani ka kohë që s'del nga pragu jashtë
se sytë pus e terr i janë zënë
thua kamxhiku që i rrahu vitet
te drit' e shuar gjurmët t'i ketë lënë.
Ka kohë që malli e mundon, e djeg,
t'i shohë nipat sy më sy, t'u qeshë,
po errësira, «mjegullpagdhendura»,
e palëvizur i varet mbi qerpikë.
Veç kur dëbora ulet mbi Moravë
ai i sigurt tek dritarja ndalet,
nën dritën e shuar seç i njomen sytë:
— Pa shih, pa shih, dëbora zbardhi malet!

DALLËNDYSHEVE QË IKIN

Merrni pak baltë Shqipërie,
pak gaz e këngë nga zemra jonë
dhe ua çoni kudo qofshin
gjithë proletarëve mbi glob.

Merrni nga fushat fëshfërimën,
zverdhjen e grurit si flori;
nga malet merrni bubullimën,
fluturimin e shqipes në liri.

Mes mjegullës që ngrejnë kohët
u çoni këtë grusht me yje,
këtë përshëndetje Shqipërie.

Eshtë këngë jonë më e bukura,
merreni pas, o dallëndyshe...
Mes erërash globi tendos muskujt
dhe këngës sonë i kthen përgjigje.

TI NËPËR VITE REND...

Heroinës së Popullit Qybra Sokoli

Sa mëngjese zbardhën që nga ajo ditë?

Sa herë u ul dielli mbi këtë gur
ku ti mbështete kokën e bukur
dhe pëshpërrite fjalët e fundit
për të gjitha dashuritë!?

Për të tridhjetetetën herë

pranvera erdhi dhe të përshëndoshi,
për të tridhjetetetën herë
shkriu përroi i zhurmshëm
pranë teje
dhe seç të tha,
dhe seç të foli...
Zgjohu, Qybra moj, zgjohu...

Kjo zemra jote zjarr mes mijëra zjarresh,
Qybra, moj motër, flakë përmbi krisma,

në synë e bukur ëndrra merrte krahë,
në ëndrrën tënde zinte fill liria.

«Eja, — i thirre
dhe u ngrite në këmbë, —
eja të qëllojmë bashkë.
Këtë plumb,

për tokën e fyer të gjyshërve!

Këtë plumb,
për ëndrrat e prishura të nuseve!

Këtë plumb,
për klithmën e paqarë të fëmijëve!

Këtë plumb,
për plumbin që vuri në shenjë
fluturimin e lirë të shqipeve!

Eja, — i thirre
dhe i zgjate pranverat e tua! —
Mbahu pas ëndrrës sime,
pas këngës sime,
pas jetës sime...»

Po ç'pate, Domosdovë, ç'pate?
Ç'ta sëmboi gjoksin shkëmb e gur?
Pse t'u drodhën eshtrat nëpër shpate?
Pse klithi shqiponja në flamur?!

— Ooh, ku paske rënë!
Ooh, ku ke qëlluar!
Predh! Murtajë e zezë!
Bish! O e tërbuar!

Drit' e syrit ç't'u shua ngadalë
e me një copëz diell brenda
shkau përmbi fushë,
toka gjoksin shtrëngoi tërë plagë,
kafshoi dhimbjen me emrin tënd në buzë:

— Ti kaq e re, ti kaq e bukur,
ti piköz loti përmbi halle
këndove këngën me grykë të pushkës,
thirre lirinë që nga malet.

Ti kaq e re, ti kaq e bukur...
Kënga përgjysmë në ditar
dora e shokëve shfleton udhët
dhe zemrat zemrës iso i mbajnë.

Rri syri yt te dhimbja e shokëve,
përmbi Katjel gjaku pikë-pikë
komandant Rizai u bën udhë lotëve:
— Ngrehu. trimëreshë, ngrehu, Qybra, bijë.

Dorë e tij e plakur
të shket përmbi ballë
zemër e drithëruar
të ulet mbi buzë.

— Mos ia lini çupës gjakun të m'i thahet!
Mos ia lini plumbin në grykë të pushkës!
Plumbi i pa shkrehur, këngë e pakënduar,
të gjëmojn' në fusha, mbi male kaluar!

Krisni pushkë, djema,
zjarr mbi Domosdovë,
Qybrën nisim nuse
gjallë në mes tonë!

Krisni pushkë, djema,
e shtrenjtë është liria,
Qybra nuk ka vdekur
se rron Shqipëria!

PASQYRE E LËNDES

Kjo ditë	3
Koncerti i fëmijëve	4
Duke pritur një letër	6
Peizazh	8
Një grusht arra	10
Minarotët e turnit të tretë	12
Neteve të verës	13
Çapi ynë	14
Liri Geros	15
Para bustit të Shote Galicës	16
Një mëngjes tek Migjeni	18
Blirët në mbrëmje	21
Na ishte një dhe...	22
Të kisha thënë...	23
Mall...	24
U gënjenkérke lehtë	25
Kur vjen pranvera	27
Ka ca fjalë të tilla	30
Vajzë e fushës, lule e fushës	31
Mështekna e bardhë	32
Peizazhe shtatori	33
Kosovë...	35
Te shtëpia e vjetër	36
Jetë	38
Vinte një mandatë	41
Në qerren e madhe sa bota	43
Duke shpjeguar Naimin	45
Në qytetin tënd unë erdha rastësisht	46
Dëbora zbardhi malet	48
Dallëndyshëve që ikin	49
Ti nëpër vite rend... (poemth)	51

Balashi, A.

Përgjigje. Poezi. [Red.: I.

Thoma J. T., «Naim Frashëri», 1983.
56 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-1

B 21

Tirazhi: 1500 kopje Formati: 70x100/32 Stash: 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1983

